



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosovo
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KRYETARI I KOMUNËS

Në bazë të neneve 11 dhe 13 të Ligjit për vetëqeverisje lokale nr.03/L-040, neneve 14 dhe 16 të Statutit të Komunës së Podujevës nr.prot.01-020/01/0050862/18, si dhe në implementim të Marrëveshjes së Bashkëpunimit, e lidhur mes Komunës së Podujevës, “Fondacionit Firdeus” dhe Fondacionit “Shqiptarët për Shqiptarët”-Kosovë, nr.prot.02-020/01-0025697/22 datë 07.04.2022, në bashkëpunim dhe koordinim me Fondacionin e cekur, merr këtë;

V E N D I M

Neni 1

Formohet komisioni i përbashkët ad-hoc për verifikimin dhe vlerësimin e aplikacioneve / kërkesave dhe përzgjedhjen e 22 familjeve me gjendje të rëndë ekonomike dhe të banimit në Komunën e Podujevës, përfutuese të shtëpive të banimit të ndërtuara nga “Fondacionit Firdeus”-Tiranë Republika e Shqipërisë dhe Fondacionit “Shqiptarët për Shqiptarët”-Kosovë, në bashkëpunim me Komunën e Podujevës, në këtë përbërje;

- **Arbresha Bashota**, Drejtorja e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale-DSHMS, kryesuese
- **Ramadan Plakolli**, Drejtorja e Administratës-DA, anëtar
- **Florie Humolli**, Drejtorja e pronës Kadastrit dhe Gjeodezisë, DPKGJ, anëtare
- **Illir Haxholli**, përfaqësues i Fondacionit “Shqiptarët për Shqiptarët” anëtar
- **Ormira Dibrani**, Qendra për Punë Sociale në kuadër të DSHMS, anëtare

Neni 2

Punët dhe detyrat e komisionit janë, verifikimi i aplikacioneve / kërkesave të paraqitura për përfitim të shtëpive përkatëse të banimit, vlerësimi i tyre si dhe përzgjedhja e 22 familjeve me gjendje të rëndë ekonomike dhe të banimit, përfutuese të shtëpive të banimit të ndërtuara nga Fondacioni “Shqiptarët për Shqiptarët” në Komunën e Podujevës, si dhe çështje tjera të parapara me Marrëveshjen përkatëse të Bashkëpunimit nr.prot.02-020/01-0025697/22 datë 07.04.2022 e lidhur mes Komunës së Podujevës, “Fondacionit Firdeus” dhe Fondacionit “Shqiptarët për Shqiptarët”-Kosovë.

Neni 3

Për punën e kryer komisioni përgatit raport në formë të shkruar dhe të njëjtin ia dorëzon Kryetarit të Komunës dhe nga një kopje Fondacioneve të lartcekura.

Neni 4

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Iu dërgohet;
Anëtarëve të Komisionit, përmes DSHMS
Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale-DSHMS
QSHQ/Arkivës

Nr.Prot. 02.020/04-00037921/23
Podujevë, datë: 09.06.2023.





Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva



KRYETARI I KOMUNËS

Bazuar në nenin 58 shkronja b) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/ L – 040, nenin 61 paragrafi 1.2 të Statutit të Komunës nr. 01-020/01-0050862 të datës 29 qershor 2018, nenin 11 paragrafi 2, ndërlidhur me nenin 3 paragrafi 3, nenin 26 paragrafi 1, paragrafi 3.1 dhe 3.2, të Rregullores për Kushtet Kriteret dhe Procedurat e Ndarjes së Subvencioneve nr.01-016/01-0030667/22 të datës 29.04.2022, sipas rekomandimit dt 05.06.2023 të Komisionit të ngritur me vendimin e Kryetarit të Komunës nr. 02-020/04-0054227/22 të datës 04.07.2022, i ndryshuar dhe plotësuar me vendimin nr.prot.02-020/04-0008957/23 të datës 01.02.2023, për shqyrtimin dhe vlerësimin e kërkesave individuale për ndarje të subvencione, lidhur me shqyrtimin e kërkesës nr.prot 02-016/01-0038353/23, të datës 05.06.2023, merr:

V E N D I M PËR PËRKRAHJE FINANCIARE

Neni 1

z.Xhevat Blakçori nga fshati Letanc Komuna e Podujevës, për shkak të gjendjes së rëndë shëndetësore dhe në pamundësi të mbulimit të shpenzimeve dhe trajtimit të mëtutjeshëm mjekësor i jepet ndihmë financiare në shumë 1000.00€.

Neni 2

Mjetet financiare ndahen nga kategoria e subvencioneve dhe transfereve në kuadër të Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale dhe të njëjtat barten përmes bankës në llogarinë bankare të birit të tij z.Amir Blakçori.

Neni 3

Zbatimin e vendimit e bën Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale.

Neni 4

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

U dërgohet:

Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale-DSHMS.

QSHQ/Arkivit.

z.Xhevat Blakçori (njoftohet përmes DSHMS-së)

Nr.prot 02-400/03-0038886/23
Podujevë, datë, 05.06.2023





Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosovo
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KRYETARI I KOMUNËS

Bazuar në nenet 13, 17 shkronja h) dhe 58 shkronja c) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr.03/L-040, nenin 35.5 të Ligjit nr.04/L-032 për Arsimin Parauniversitar në Republikës e Kosovës, nenin 12 paragrafët 1,2 dhe 3 të Udhëzimit Administrativ të (MASH) nr.151/2020 për detyrat dhe përgjegjësitë e drejtorit dhe zëvendës drejtorit të institucionit publik edukativo-arsimor dhe aftësues parauniversitar në Republikën e Kosovës, procedurat e zgjedhjes dhe emërimit, përfundimit të kontratës dhe emërimit të përkohshëm, si dhe nenet 16, 19 parag. 1.8 dhe 61 parag.1.3 të Statutit të Komunës nr.01-020/01-0050862/18, në propozim të drejtorit të Drejtorisë së Arsimit nr. prot. 02-610/01-0038927/23, datë 07.06.2023, nxjerrë këtë;

VENDIM

PËR EMËRIMIN E PËRKOHSHËM NË POZITËN E DREJTORIT TË SHFMU “JETULLAH GASHI” NË DOBËRDOL KOMUNA E PODUJEVËS

Neni 1

z.Fatmir Rekaliiu, nga fshati Bajçinë, Komuna e Podujevës, me nr.personal të letërnjoftimit nr.02-610/01-0038927/23, me kualifikim Bachelor i Gjeografisë.

Emërohet përkohësisht në pozitën e Drejtorit të SHFMU “Jetullah Gashi”, në Dobërdol Komuna e Podujevës.

Neni 2

I përmenduri sipas nenit 1 të këtij vendimi emërohet përkohësisht deri në zgjedhjen/emërimin e Drejtorit sipas procedurës së rregullt të konkursit apo deri në një akt tjetër administrativ.

Neni 3

Kushtet e punës, të drejtat, përgjegjësitë dhe paga mujore caktohen me kontratën e punës.

Neni 4

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Neni 5

Zbatimin e vendimit dhe çështjeve tjera që ndërlidhen me këtë vendim e bën Drejtoria e Arsimit.

I dërgohet:
Drejtorisë së Arsimit
Të emëruarit
QSHQ/Arkivit

Nr. prot. 02-020/05-0039234/23
Podujevë, datë: 07.06.2023



Kryetari i Komunës
Shpejtim Bulliqi



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KRYETARI I KOMUNËS

Bazuar në nenet 13, 17 shkronja h) dhe 58 shkronja c) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr.03/L-040, nenin 35.5 të Ligjit nr.04/L-032 për Arsimin Parauniversitar në Republikës e Kosovës, nenin 12 paragrafët 1,2 dhe 3 të Udhëzimit Administrativ të (MASH) nr.151/2020 për detyrat dhe përgjegjësitë e drejtorit dhe zëvendës drejtorit të institucionit publik edukativo-arsimor dhe aftësues parauniversitar në Republikën e Kosovës, procedurat e zgjedhjes dhe emërimit, përfundimit të kontratës dhe emërimit të përkohshëm, si dhe nenet 16, 19 parag. 1.8 dhe 61 parag.1.3 të Statutit të Komunës nr.01-020/01-0050862/18, në propozim të Drejtorit të Drejtorisë së Arsimit 02-610/01-0038927/23 , datë 07.06.2023, nxjerrë këtë;

VENDIM PËR EMËRIMIN E PÛRKOHSHËM NË POZITËN E ZËVENDËS DREJTORIT / ESHËS TË SHKOLLËS FILLORE TË MESME TË ULËT - SHFMU "SHABAN SHALA" NË PODUJEVË

Neni 1

zni. Aisela Uka, me vendbanim në Podujevë, me nr. personal të letërnjoftimit , e kualifikuar *mësuese e Gjuhës dhe letërsisë Shqipe*,

Emërohet përkohësisht në pozitën Zëvendës Drejtoreshë e Shkollës Fillore të Mesme të Ulët- SHFMU "Shaban Shala" në Podujevë.

Neni 2

E përmendura sipas nenit 1 të këtij vendimi emërohet përkohësisht deri në zgjedhjen/emërimin e zëvendës Drejtorit/eshës sipas procedurës së rregullt të konkursit apo deri në një akt tjetër administrativ.

Neni 3

Kushtet e punës, të drejtat, përgjegjësitë dhe paga mujore caktohen me kontratën e punës.

Neni 4

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Neni 5

Zbatimin e vendimit dhe çështjeve tjera që ndërlidhen me këtë vendim e bën Drejtoria e Arsimit.

I dërgohet:
Drejtorisë së Arsimit
Të emëruarës
QSHQ/Arkivit

Nr. prot. 02-020/05-0039237/23
Podujevë, datë: 07.06.2023



Kryetari i Komunës
Shejtim Balliqi



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva



KRYETARI I KOMUNËS

Bazuar në nenet 13, 17 shkronja h) dhe 58 shkronja c) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr.03/L-040, nenin 35.5 të Ligjit nr.04/L-032 për Arsimin Parauniversitar në Republikës e Kosovës, nenin 12 paragrafët 1,2 dhe 3 të Udhëzimit Administrativ të (MASH) nr.151/2020 për detyrat dhe përgjegjësitë e drejtorit dhe zëvendës drejtorit të institucionit publik edukativo-arsimor dhe aftësues parauniversitar në Republikën e Kosovës, procedurat e zgjedhjes dhe emërimit, përfundimit të kontratës dhe emërimit të përkohshëm, si dhe nenet 16, 19 parag. 1.8 dhe 61 parag.1.3 të Statutit të Komunës nr.01-020/01-0050862/18, në propozim të drejtorit të Drejtorisë së Arsimit nr. prot. 02-610/01-0038927/23 , datë 07.06.2023, nxjerrë këtë;

VENDIM

PËR EMËRIMIN E PËRKOHSHËM NË POZITËN E ZËVENDËS DREJTORIT TË IAAP - "ISA BOLETINI" NË PODUJEVË

Neni 1

z.Xhevdet Zhugolli, nga fshati Buricë, Komuna e Podujevës, me nr.personal të letërnjoftimit 10101302 me kualifikim Menaxhment dhe Informatik, Ekonomist i Diplomuar.

Emërohet përkohësisht në pozitën e Zëvendës Drejtorit të IAAP "Isa Boletini", në Podujevë.

Neni 2

I përmenduri sipas nenit 1 të këtij vendimi emërohet përkohësisht deri në zgjedhjen/emërimin e zëvendës drejtorit sipas procedurës së rregullt të konkursit apo deri në një akt tjetër administrativ.

Neni 3

Kushtet e punës, të drejtat, përgjegjësitë dhe paga mujore caktohen me kontratën e punës.

Neni 4

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Neni 5

Zbatimin e vendimit dhe çështjeve tjera që ndërlidhen me këtë vendim e bën Drejtoria e Arsimit.

I dërgohet:
Drejtorisë së Arsimit
Të emëruarit
QSHQ/Arkivit

Nr. prot. 02-020/05-0039235/23
Podujevë, datë: 07.06.2023



Kryetari i Komunës
Shpejtim Bulliqi



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva



KRYETARI I KOMUNËS

Bazuar në nenet 13 dhe 58 shkronja b) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/L-040, nenet 16 dhe 61 paragrafi 1.2 të Statutit të Komunës nr.prot. 01-020/01-0050862/18, të datës 29 qershor 2018, nenin 11 paragrafi 2, ndërlidhur me nenin 3 paragrafi 3 dhe nenin 27 paragrafi 1.7 të Rregullores për kushtet kriteret dhe procedurat e ndarjes së subvencioneve nr.prot.01-016/01-0030667/22 të datës 29.04.2022, në kërkesë nr.prot.09-400/04-0027409/23 të datës 19.04.2023 dhe sipas rekomandimit të Komisionit të ngritur me Vendimin e Kryetarit të Komunës nr.prot.02-020/04-0054227/22 datë 04.07.2022 i ndryshuar dhe plotësuar me vendimin nr.prot.02-020/04-0008957/23 të datës 01.02.2023, për shqyrtimin dhe vlerësimin e kërkesave individuale për ndarje të subvencioneve merr:

V E N D I M PËR PËRKRAHJE FINANCIARE

Neni 1

z.Tefik Jaha, shkrimtar nga fshati Balloc, Komuna e Podujevës, për botimin e librit shkencorë - historik me titull “Demë Ahmeti – Përpyekja e tij dhe e Shqiptarëve për Formimin e Shtetit të tyre Para dhe Gjatë Luftërave Austro- Hungareze, Ruse - Osmane”, mbështetet me mjete financiare në shumë 1000.00€.

Neni 2

Mjetet financiare sipas këtij vendimi ndahen nga kategoria subvencione dhe transfere në kuadër të Drejtorisë së Kulturës Rinisë dhe Sportit dhe të njëjtat bartet përmes bankës në llogarinë e të përmendurit.

Neni 3

Për zbatimin e këtij vendimi kujdesen Drejtoria e Kulturës Rinisë dhe Sportit dhe Drejtoria e Buxhetit dhe Financave, në përputhje me rregullat dhe procedurat e shpenzimit të mjeteve financiare nga kategoria e cekur buxhetore në funksion të realizimit të mbështetjes financiare sipas këtij vendimi.

Neni 4

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

U dërgohet:

Drejtorive përkatëse.

QSHQ/Arkivit.

z.Tefik Jaha (njoftohet përmes DKRS-së).

Nr.prot 02-400/03-0039412/23
Podujevë, datë, 08.06.2023



Kryetari i Komunës
Shpëritim Bulliqi



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva



KRYETARI I KOMUNËS

Bazuar në nenin 13 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr.03/L-040, nenin 14 të Statutit të Komunës nr. 01-020/01-0050862/18, nxjerr:

VENDIM

Neni 1

Ngritet Komisioni për vlerësimin e rrezikshmërisë së gjendjes së objekteve banesore në pronësi të Komunës në rrugën “Nuhi Gashi” Podujevë, në këtë përbërje:

Afrim Mulliqi, zyrtar në DSHPMSh, kryesues
Arbëresha Bashota, zyrtare në DSHMS- anëtare
Fidan Salihu, zyrtar në DPUMM- anëtar
Blerta Plakolli, zyrtare në DPKGJ- anëtare
Ilaz Hoti, zjarrfikës-anëtar

Neni 2

Komisioni sipas nenit 1 të këtij vendimi është i obliguar që në detaje të vlerësoj gjendjen faktike të objekteve, të bëjë konstatimin mbi shkallën e rrezikshmërisë në aspektin urbanistik, arkitektonik, statik, infrastrukturor dhe të kushteve të banimit në objektet e cekura banesore.

Neni 3

Për punën e kryer komisioni përgatit raport në formë dhe informon Zyrën e kryetarit brenda një afati sa më të shkurtër kohor.

Neni

Vendimi hynë fuqi ditën e nënshkrimit.

Nr. prot. 02-020/04-0039505/23
Podujevë, datë 08.06.2023





Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva



KRYETARI I KOMUNËS

Në bazë të nenit 13 të Ligjit për Vetqeverisje Lokale nr.03/L-040 dhe nenit 14 dhe 16 të Statutit të Komunës nr.01-020/01-0050862/18, sipas Ftesës të datës 05.06.2023 nga Bashkia e Lezhës për pjesmarrje në “ Hapjen e Sezonit Turistik 2023”, jep këtë:

AUTORIZIM

z.Vigan Salihu, Drejtor i Drejtorisë së Planifikimit të Zhvillimit Ekonomik, autorizohet për udhëtim zyrtar jashtë vendit. Udhëtimi do të realizohet më datën 10-11.06.2023 në Republikën e Shqipërisë, qëllimi i vizitës është pjesmarrja në eventin “ Hapjen e Sezonit Turistik ” në Shëngjin, i cili do të organizohet nën kujdesin e veçantë të Kryetarit të Komunës së Shëngjinit z. Pjerin Nderu. Kompenzimi i mëditjes dhe mbulimi i shpenzimeve tjera do të realizohet sipas tarifës dhe të njejtin do ta ekzekutojë Drejtoria e Financave.

U dërgohet:

Vigan Salihu
Drejtorisë së Financave
QSHQ/Arkivit

Nr.prot. 02-016/01-0039604/23
Podujevë, 09.06.2023

Kryetari i Komunës
Shpetim Bulliqi





Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva



KRYETARI I KOMUNËS

Bazuar në nenet 13 dhe 58 shkronja (i) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/ L – 040, nenet 16, 61 paragrafi 1.9 të Statutit të Komunës së Podujevës nr. 01-02/01-0050862/18, nenin 3, nenin 11 paragrafi 1 dhe nenit 17 paragrafi 1.10 të Rregullores për Kushtet Kriteret dhe Procedurat e Ndarjes së Subvencioneve nr.prot.01-016/01-0030667/22 të datës 29.04.2022, Vendimin nr.prot.01-400/03-0084071/22, të datës 29.09.2022, Për Miratimin e Projektbuxhetit të Komunës së Podujevës për vitin 2023 dhe Parashikimet Buxhetore 2024-2025, në implementimin e projektit Subvencionimi i Investimeve në Kapacitete Prodhuese të NMVM-ve, Vendimit të Kryetarit të Komunës nr.prot.02-400/01-0022116/23 të datës 24.03.2023, për lejimin e mjeteve financiare për subvencionimin e 16 bizneseve përfituese në Komunën e Podujevës, si dhe në rekomandim të Komisionit Ad-Hoc të ngritur me vendimin e Kryetarit të Komunës nr.prot.02-020/04-0015276/23 të datës 23.02.2023, për shqyrtimin edhe vlerësimin e kërkesave për ndarje të subvencioneve sipas Ftesës Publike nr.prot.15-300/01-0004082/23 të datës 13.01.2023, Kryetari i Komunës merr;

V E N D I M

Neni 1

Nuriqe Kaqiu BI, Biznesi Individual B.I – NUI 8107823 me seli në fshatin Shakovicë, Komuna e Podujevës mbështetet me mjete financiare në shumë 4959.00€.

Neni 2

Subvencionimi bëhet sipas Ftesës Publike nr.prot.15-300/01-0004082/23 të datës 13.01.2023, të publikuar nga Drejtoria Planifikimit dhe Zhvillimit Ekonomik, në emër të kompensimit të mjeteve financiare për sigurimin/ blerjen e pajisjeve nga ana e përfituesit me qëllim të implementimit të projektit Subvencionimi i Investimeve në Kapacitete Prodhuese të NMVM-ve.

Neni 3

Mbështetja financiare bëhet me qëllim të promovimit dhe zhvillimit të bizneseve në territorin e Komunës së Podujevës.

Neni 4

Mjetet buxhetore sipas nenit 1 të këtij vendimi ndahen nga kategoria e subvencioneve dhe transfereve në kuadër të Drejtorisë së Planifikimit dhe Zhvillimit Ekonomik dhe përmes bankës barten në llogarinë e “Nuriqe Kaqiu BI”.

Neni 5

Zbatimin e Vendimit e bën Drejtoria e Buxhetit dhe Financave në bashkëpunim dhe koordinim me Drejtorinë Planifikimit dhe Zhvillimit Ekonomik.

Neni 6

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Nr.prot, 02-422/01-0039802/23
Podujevë, datë, 03.06.2023

Kryetari i Komunës
Shpejtim Bulliqi





Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosovo
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva



KRYETARI I KOMUNËS

Bazuar në nenin 58 shkronja b të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/ L – 040, nenin 61 paragrafi 1.2 të Statutit të Komunës nr. 01-02/01-0050862/18, nenet 8 dhe 22 të Rregullores për Kushtet Kriteret dhe Procedurat e Ndarjes së Subvencioneve nr.prot.01-016/01-0030667/22 të datës 29.04.2022, Vendimin nr.prot.01-400/03-0084071/22, të datës 29.09.2022, Për Miratimin e Projektbuxhetit të Komunës së Podujevës për vitin 2023 dhe Parashikimet Buxhetore 2024-2025, në implementimin e projektit "Furnizim dhe Montim i Sera Bujqësore", në rekomandim të Komisionit Ad-Hoc të ngritur me vendimin e Kryetarit të Komunës nr.prot.02-020/04-0029845/23, të datës 28.04.2023, Për Shqyrtimin edhe Vlerësimin e Kërkesave për Ndarje të Subvencioneve sipas Ftesës Publike nr.12-320/01-0022213/23, të datës 24.03.2023, Kryetari i Komunës, merr:

V E N D I M

Neni 1

1. Lejohen mjete financiare për subvencionimin e 45 (dyzetepesë) fermerëve përfitues të Komunës së Podujevës për projektin "Furnizim dhe Montim i Sera Bujqësore".
2. Mbështetja e fermerëve do të bëhet sipas kushteve dhe kriterëve të përcaktuara nga Drejtoria e Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural në Ftesën publike për aplikim në projektin "Furnizim dhe Montim i Sera Bujqësore", përkatësisht fermerët përfitues do të participojnë 30% të vlerës së projektit, kurse pjesa tjetër e projektit mbështetet nga Komuna.

Neni 2

Qëllim i realizimit të këtij projekti është promovimi dhe zhvillimi i bujqësisë në territorin e Komunës së Podujevës.

Neni 3

Lista e aplikuesve të përzgjedhur për implementimin e projektit: "Furnizim dhe Montim i Sera Bujqësore" sipas nenit 1 është pjesë përbërëse e këtij Vendimi.

Neni 4

Për zbatimin e Vendimit kujdeset Drejtoria e Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural në bashkëpunim me Komisioni për shqyrtimin e kërkesave për mbështetje dhe ofrim të ndihmave nga kategoria e mjeteve buxhetore subvencione dhe transfere, i cili do të bëjë verifikimin, konstatimin dhe vlerësimin e përmbushjes së kushteve dhe kriterëve nga ana e fermerit/es si dhe çështjeve tjera të parapara sipas ftesës publike përkatëse.

Neni 5

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Nr. prot 02-400/04-0040028/23
Podujevë, datë 12.06.2023



Kryetari i Komunës
Shpejtim Bulliqi



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosovo
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KRYETARI I KOMUNËS

Bazuar në nenet 13 dhe 58 shkronjat g) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr.03/L-040 dhe nenet 14 dhe 61 paragraf 1.7 të Statutit të Komunës, nr.01-020/01-0050862/18, sipas kërkesës së Drejtorit të Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave nr.prot. 02-016/01-0039812/23 datë 09.06.2023, merr:

V E N D I M

Neni 1

z.Ardonis Jusufi, zyrtar i të hyrave financiare në kuadër të Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave, krahas punëve dhe detyrave nga pozita që mbanë, autorizohet për kryerjen punëve dhe detyrave nga kompetencat dhe përgjegjësitë e pozitës së zyrtarit të pasurisë në Drejtorinë e cekur.

Neni 2

Autorizimi sipas këtij vendimi lëshohet me qëllim të kryerjes sa më efektive të punëve dhe detyrave të punës nga pozita e zyrtarit të pasurisë dhe i njëjti vlen deri në një akt tjetër administrativ.

Neni 3

Për zbatimin e vendimit kujdeset Drejtoria e Buxhetit dhe Financave në bashkëpunim dhe koordinim me Zyrën e Personelit.

Neni 4

Vendimi hynë në fuqi ditën e nënshkrimit.

Me këtë vendim njoftohen:

I Autorizuari

z. Fatlum Osmani, drejtor i DBF

Zyra e Personelit

QSHQ/Arkiva

Nr.prot. 02-020/05-00400.95/23
Podujevë, datë: 13.06.2023



Kryetari i Komunës
Shpejtim Bulliqi



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KRYETARI I KOMUNËS

Bazuar në nenet 13, 58 shkronjat b), g) Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/L-040, nenin 17 paragrafi 3 dhe nenin 18 të Ligjit të Punës nr. 03/L-212 dhe nenet 16 dhe 61 paragrafi 1.7 të Statutit të Komunës nr. 01-020/01-0050862/18, sipas kërkesës së U.D. Drejtorit të QKMF-së dhe pëlqimit nga Drejtoria e Administratës me nr.prot. 03-016/01-0039537/23 dt 08.06.2023, Kryetari i Komunës, nxjerr:

VENDIM PËR SISTEMIM TË PËRKOHSHËM

I

z.Sami Pajziti, shofer në kuadër të Administratës komunale, sistemohet në punë dhe detyra të tjera të punës përkohësisht jo më gjatë se 30 (tridhjetë) ditë;

- *Shofer në Qendrën Kryesore të Mjekësisë familjare-QKMF, shërbimin i dializës*

z.Bahri Demiri, shofer në kuadër të Administratës komunale, sistemohet në punë dhe detyra të tjera të punës përkohësisht jo më gjatë se 30 (tridhjetë) ditë;

- *Shofer në Qendrën Kryesore të Mjekësisë familjare-QKMF, shërbimin i dializës*

II

Sistemimi i të përmendurve bëhet për shkak të rritjes së nevojave për ofrimin e shërbimeve në teren nga QKMF posaçërisht për rastet e dializës.

III

Fillimisht sipas Nenit I të këtij Vendimi në kryerjen e punëve dhe detyrave sistemohet z.Sami Pajziti, pastaj për kryerjen e punëve dhe detyrave të njëjta sistemohet z.Bahri Demiri.

IV

Zbatimin e vendimit e bën Zyra e Personelit në bashkëpunim dhe koordinim me Drejtorinë e Administratës dhe Drejtorinë e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale.

V

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

I dërgohet:
Drejtorisë së Administratës
Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale –QKMF-së.
Zyrës së personelit
Të sistemuarëve
QSHQ/Arkivit

Nr. prot 02-020/05-0041046/23
Podujevë, datë 45.06.2023





Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva



KRYETARI I KOMUNËS

Bazuar në nenet 13 dhe 58 shkronja (i) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/ L – 040, nenet 16, 61 paragrafi 1.9 të Statutit të Komunës së Podujevës nr. 01-02/01-0050862/18, nenin 3, nenin 11 paragrafi 1 dhe nenit 17 paragrafi 1.10 të Rregullores për Kushtet Kriteret dhe Procedurat e Ndarjes së Subvencioneve nr.prot.01-016/01-0030667/22 të datës 29.04.2022, Vendimin nr.prot.01-400/03-0084071/22, të datës 29.09.2022, Për Miratimin e Projektbuxhetit të Komunës së Podujevës për vitin 2023 dhe Parashikimet Buxhetore 2024-2025, në implementimin e projektit Subvencionimi i Investimeve në Kapacitete Prodhuese të NMVM-ve, Vendimit të Kryetarit të Komunës nr.prot.02-400/01-0022116/23 të datës 24.03.2023, për lejimin e mjeteve financiare për subvencionimin e 16 bizneseve përfituese në Komunën e Podujevës, si dhe në rekomandim të Komisionit Ad-Hoc të ngritur me vendimin e Kryetarit të Komunës nr.prot.02-020/04-0015276/23 të datës 23.02.2023, për shqyrtimin edhe vlerësimin e kërkesave për ndarje të subvencioneve sipas Ftesës Publike nr.prot.15-300/01-0004082/23 të datës 13.01.2023, Kryetari i Komunës merr;

V E N D I M

Neni 1

Beqa Sh.P. K”, Shoqëri me përgjegjësi të kufizuar – NUI 833 0613 me seli në fshatin Dumnicë e Poshtme, Komuna e Podujevës mbështetet me mjete financiare në shumë 9,600.00€.

Neni 2

Subvencionimi bëhet sipas Ftesës Publike nr.prot.15-300/01-0004082/23 të datës 13.01.2023, të publikuar nga Drejtoria Planifikimit dhe Zhvillimit Ekonomik, në emër të kompensimit të mjeteve financiare për sigurimin/ blerjen e pajisjeve nga ana e përfituesit me qëllim të implementimit të projektit Subvencionimi i Investimeve në Kapacitete Prodhuese të NMVM-ve.

Neni 3

Mbështetja financiare bëhet me qëllim të promovimit dhe zhvillimit të bizneseve në territorin e Komunës së Podujevës.

Neni 4

Mjetet buxhetore sipas nenit 1 të këtij vendimi ndahen nga kategoria e subvencioneve dhe transfereve në kuadër të Drejtorisë së Planifikimit dhe Zhvillimit Ekonomik dhe përmes bankës barten në llogarinë e “Beqa SH.P.K”.

Neni 5

Zbatimin e Vendimit e bën Drejtoria e Buxhetit dhe Financave në bashkëpunim dhe koordinim me Drejtorinë Planifikimit dhe Zhvillimit Ekonomik.

Neni 6

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Nr.prot, 02-400/03-0041048/23
Podujevë, datë, 15.06.2023





Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosovo
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva



KRYETARI I KOMUNËS

Bazuar në nenet 13 dhe 58 shkronja b) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/L- 040, nenet 16 dhe 61 paragrafi 1.2 të Statutit të Komunës nr.prot. 01-020/01-0050862/18, të datës 29 qershor 2018, nenin 11 paragrafi 2, ndërlidhur me nenin 3 paragrafi 3 dhe nenin 15 paragrafi 1.6 të Rregullores për kushtet kriteret dhe procedurat e ndarjes së subvencioneve nr.prot.01-016/01-0030667/22 të datës 29.04.2022, në kërkesë nr.prot.02-400/04-0040949/23 të datës 15.06.2023 dhe sipas rekomandimit të Komisionit të ngritur me Vendimin e Kryetarit të Komunës nr.prot.02-020/04-0054227/22 datë 04.07.2022 i ndryshuar dhe plotësuar me vendimin nr.prot.02-020/04-0008957/23 të datës 01.02.2023, për shqyrtimin dhe vlerësimin e kërkesave individuale për ndarje të subvencioneve merr:

V E N D I M PËR PËRKRAHJE FINANCIARE

Neni 1

znj.Diella Kika, nga Podujeva, nxënëse e gjimnazit “Aleksandër Xhuvani”, për përfaqësimin e Republikës së Kosovës në garat evropiane të fizikës në Gjermani, mbështetet me mjete financiare në shumë 500.00€.

Neni 2

Mjetet financiare sipas këtij vendimi ndahen nga kategoria subvencione dhe transfere në kuadër të Drejtorisë së Arsimit dhe të njëjtat bartet përmes bankës në llogarinë e të përmendurës.

Neni 3

Për zbatimin e këtij vendimi kujdesen Drejtoria e Arsimit dhe Drejtoria e Buxhetit dhe Financave, në përputhje me rregullat dhe procedurat e shpenzimit të mjeteve financiare nga kategoria e cekur buxhetore në funksion të realizimit të mbështetjes financiare sipas këtij vendimi.

Neni 4

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

U dërgohet:

Drejtorive përkatëse.

QSHQ/Arkivit.

Znj.Diella Kika (njoftohet përmes DKRS-së).

Nr.prot.02-114/01-0042381/23
Podujevë, datë, 22. 06. 2023



Kryetari i Komunës
Shpejtim Bulliqi



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva



KRYETARI I KOMUNËS

Bazuar në nenin 58 shkronja b) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/ L – 040, nenin 61 paragrafi 1.2 të Statutit të Komunës nr. 01-020/01-0050862 të datës 29 qershor 2018, nenin 11 paragrafi 2, ndërlidhur me nenin 3 paragrafi 3, nenin 26 paragrafët 1, paragrafi 3.1 dhe 3.2, të Rregullores për Kushtet Kriteret dhe Procedurat e Ndarjes së Subvencioneve nr.01-016/01-0030667/22 të datës 29.04.2022, sipas rekomandimit të Komisionit të ngritur me vendimin e Kryetarit të Komunës nr. 02-020/04-0054227/22 të datës 04.07.2022, i ndryshuar dhe plotësuar me vendimin nr.prot.02-020/04-0008957/23 të datës 01.02.2023, për shqyrtimin dhe vlerësimin e kërkesave individuale për ndarje të subvencione, lidhur me shqyrtimin e kërkesës nr.prot 06-400/04-0042075/23, të datës 21.06.2023, merr:

V E N D I M PËR PËRKRAHJE FINANCIARE

Neni 1

znj.Nadire Zhinipotoku nga fshati Tërnavë, Komuna e Podujevës, për shkak të gjendjes së rëndë shëndetësore dhe në pamundësi të mbulimit të shpenzimeve dhe trajtimit të mëtutjeshëm mjekësor i jepet ndihmë financiare në shumë 500.00€.

Neni 2

Mjetet financiare ndahen nga kategoria e subvencioneve dhe transfereve në kuadër të Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale dhe të njëjtat bartet përmes bankës në llogarinë bankare të bashkëshortit të të përmendurës z. Ejup Zhinipotoku.

Neni 3

Zbatimin e vendimit e bën Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale.

Neni 4

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

U dërgohet:

Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale-DSHMS.

QSHQ/Arkivit.

znj.Nadire Zhinipotoku (njoftohet përmes DSHMS-së)

Nr.prot 02-422/04-0042819/23
Podujevë, datë, 03.06.2023





Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva



KRYETARI I KOMUNËS

Bazuar në nenin 58 shkronja b) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/ L – 040, nenin 61 paragrafi 1.2 të Statutit të Komunës nr. 01-020/01-0050862 të datës 29 qershor 2018, nenin 11 paragrafi 2, ndërlidhur me nenin 3 paragrafi 3, nenin 26 paragrafi 3.6, të Rregullores për Kushtet Kriteret dhe Procedurat e Ndarjes së Subvencioneve nr.01-016/01-0030667/22 të datës 29.04.2022, sipas rekomandimit të Komisionit të ngritur me vendimin e Kryetarit të Komunës nr. 02-020/04-0054227/22 të datës 04.07.2022, i ndryshuar dhe plotësuar me vendimin nr.prot.02-020/04-0008957/23 të datës 01.02.2023, për shqyrtimin dhe vlerësimin e kërkesave individuale për ndarje të subvencione, lidhur me shqyrtimin e kërkesës nr.prot. 06-400/04-0042452/23, të datës 22.06.2023, merr:

V E N D I M PËR PËRKRAHJE FINANCIARE

Neni 1

znj.Shefkije Zeka nga fshati Letanc, Komuna e Podujevës, për shkak të kushteve të rënda ekonomiko-sociale si dhe gjendjes jo të mirë shëndetësore i jepet ndihmë financiare në shumë 1000.00€.

Neni 2

Mjetet financiare ndahen nga kategoria e subvencioneve dhe transfereve në kuadër të Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale dhe të njëjtat bartet përmes bankës në llogarinë bankare të përmendurës.

Neni 3

Zbatimin e vendimit e bën Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale.

Neni 4

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

*U dërgohet:
Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale-DSHMS.
QSHQ/Arkivit.
Znj.Shefkije Zeka (njoftohet përmes DSHMS-së)*

Nr.prot 02-422/01-0042919/23
Podujevë, datë, 26.06.2023



**Kryetari i Komunës
Shefitim Bulliqi**



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosovo
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva



KRYETARI I KOMUNËS

Bazuar në nenin 58 shkronja b) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/ L – 040, nenin 61 paragrafi 1.2 të Statutit të Komunës nr. 01-020/01-0050862 të datës 29 qershor 2018, nenin 11 paragrafi 2, ndërlidhur me nenin 3 paragrafi 3, nenin 26 paragrafi 3.6, të Rregullores për Kushtet Kriteret dhe Procedurat e Ndarjes së Subvencioneve nr.01-016/01-0030667/22 të datës 29.04.2022, sipas rekomandimit të Komisionit të ngritur me vendimin e Kryetarit të Komunës nr. 02-020/04-0054227/22 të datës 04.07.2022, i ndryshuar dhe plotësuar me vendimin nr.prot.02-020/04-0008957/23 të datës 01.02.2023, për shqyrtimin dhe vlerësimin e kërkesave individuale për ndarje të subvencione, lidhur me shqyrtimin e kërkesës nr.prot. 06-400/03-0042450/23, të datës 22.06.2023, merr:

V E N D I M PËR PËRKRAHJE FINANCIARE

Neni 1

z.Valdon Sefa nga Podujeva, për shkak të kushteve të rënda ekonomiko- sociale si dhe gjendjes jo të mirë shëndetësore i jepet ndihmë financiare në shumë 1000.00€.

Neni 2

Mjetet financiare ndahen nga kategoria e subvencioneve dhe transfereve në kuadër të Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale dhe të njëjtat bartet përmes bankës në llogarinë bankare të përmendurit.

Neni 3

Zbatimin e vendimit e bën Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale.

Neni 4

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

U dërgohet:

Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale-DSHMS.

QSHQ/Arkivit.

z.Valdon Sefa (njoftohet përmes DSHMS-së)

Nr.prot 02-400/03-0042450/23
Podujevë, datë, 26.06.2023



Kryetari i Komunës
Shpejtim Bulliqi



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosovo
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KRYETARI I KOMUNËS

Në bazë të nenit 58 shkronja b) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/L-040, në pajtim me Rregulloren MF - Nr - 04/2017 mbi kriteret standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve dhe nenit 61 parag. 1.2 të Statutit të Komunës nr. 01-020/01-0050862/18, në Rekomandim të Komisionit vlerësues për shqyrtimin e aplikacioneve për financim publik të ojq-ve në Komunën e Podujevës për organizimin e aktiviteteve rinore/ kulturore, sipas Thirrja publike për organizimin e aktiviteteve rinore dhe kulturore, datë 13.03.2023, merr:

VENDIM

PËR MBËSHTETJE FINANCIARE ORGANIZATAT JOQEVERITARE-OJQ-VE PËR ORGANIZIMIN E AKTIVITETEVE RINORE DHE KULTURORE NË KOMUNËN E PODUJEVËS

Neni 1

Për financim publik të organizatave joqeveritare-OJQ, për realizimin e programeve/projekteve në fushën e aktiviteteve kulturore dhe rinore, sipas Thirrjes publike datë 13.03.2023, ndahen mjete financiare në shumë të përgjithshme **21,700.00 €**.

Neni 2

Drejtoria e Kulturës Rinisë dhe Sportit për kushtet dhe mënyrën e realizimit të aktiviteteve kulturore/rinore dhe për mënyrën e financimit publik, me secilin përfitues të mbështetjes financiare lidhë kontratë me shkrim në përputhje me Rregulloren mbi kriteret standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve dhe procedurën e përcaktuar në Udhëzimin për aplikuesit.

Neni 3

Lista përfundimtare e përfituesve me shumat përkatëse është pjesë përbërëse e këtij vendimi.

Neni 4

Zbatimin e vendimit e bën Drejtoria e Kulturës Rinisë dhe Sportit dhe Drejtoria e Buxhetit dhe Financave.

Neni 5

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Nr. Prot. 02-400/03-0043991/23
Podujevë, date: 30.06.2023





Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KRYETARI I KOMUNËS

Bazuar në nenet 13 dhe 58 shkronja g) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/L-040, nenit 16 dhe 61 paragrafi 1.7 të Statutit të Komunës nr. 01-020/01-0050862/18, me qëllim të caktimit të anëtarëve të Komisionit Vlerësues për vlerësimin e projekt propozimeve të bazuara në Memorandumin e Bashkëpunimit të lidhur mes Komunës së Podujevës dhe UNDP-së, “ Programi Rajonal për Demokracinë Lokale në Ballkanin Perëndimor ” (ReLOaD2) , nxjerr:

V E N D I M

Neni 1

Caktohen anëtarët e Komisionit Vlerësues për vlerësimin e projekt propozimeve bazuar në Memorandumin e Mirëkuptimit dhe atë:

z. Ardonis Jusufi, zyrtar i të hyrave financiare-Drejtoria e Buxhetit dhe Financave – anëtar

z. Fitim Bunjaku, udhëheqës i personelit

znj. Liridona Rrahmani, zyrtare për informim dhe monitorimin e mediave-Zyra për Marëdhënie me Publikun dhe Informim, caktohet anëtare rezervë

Neni 2

Anëtarët e cekur më lartë kanë për obligim që të bëjnë vlerësimin e projekt propozimeve në bazë të kriterëve të paraqitura sipas thirrjes publike të programit RELOAD 2 për organizatat e shoqërisë civile, si dhe për punët dhe përgjegjësitë tjera të cilat janë në natyrën e këtij komisioni.

Neni 3

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit, për realizimin e tij kujdesen anëtarët e komisionit.

U dërgohet:

Anëtarëve të Komisionit

Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave

Zyrës së UNDP-së

QSHQ/Arkivës

Nr.prot. 02-020/05-0044341/23
Podujevë, datë: 30.06.2023



Kryetari i Komunës
Shpejtim Bulliqi